

# Oral History Kosovo

---

“ME VENDLINDJEN NË PRAPAVI”

**“Me Vendlindjen në Prapavi”** është një libër fotografik i cili u kurua nga regjisora Kaltrina Krasniqi dhe artisti vizuel Alban Muja gjatë vitit 2011/2012. Duke dashur të lirohen nga portretimi ekzotik i Kosovës që normalisht bëhej nga gazetaria e shpejtë dhe turistët entuziastë, kuratorët vendosën që të shpërndajnë 100 aparate fotografike për një përdorim në gjithë Kosovën. Këto aparate iu dhanë të rinjëve prej moshës 15-24 vjeç. Të rinjtë kishin vetëm 30 shkrepje në dispozicion për të rrëfyer mbi preokupimet e tyre, andaj meditimi mbi vetën dhe tjerët rezultoi të jetë shumë i pasur dhe i mbushur me përbajtje që tregonte gjithçka, përvèç reprezentimit të zakonshëm që lidhet ngushtë me religionin, traditën, luftën dhe varfërinë. Në fotografitë e këtyre të rinjëve shihejjeta e një Kosove tjetër që gradualisht po regjenerohej dhe po kërkonte veten në këtë kontekst të ri politik e shoqëror.

Duke shikuar me kurreshjtje fotografitë e përzgjedhura në këtë libër, vendosëm që të kthehem dy vjet prapa dhe të bisedojmë me një nga pjesëmarrëset në këtë libër - Lirika Demiri - vajzë nga Ferizaj, studente e sociologjisë në Universitetin e Prishtinës e cila e hapë bisedën duke thënë se sociologjia e ka tërhequr “me mënyrën se si e gërshton privaten me publiken, shoqëroren me individualen”. Me tu kyçur në kuadër të këtij institucioni studimet e saj u koncentruan në kulturë dhe studime gjinore por fotografija vazhdoi të mbetet një mjet me të cilin obzervon dhe rrëfehet.

**OHI:** Si u angazhova në librin fotografik “Me Vendlindjen në Prapavi”?

**Lirika Demiri:** Ishte krejt e rastësishme; një OJQ po kërkonte aktivistë të rinjë ferizajas që përmes një aparatit fotografik për një përdorim do të rrëfenin tregimin e tyre për vendin ku jetojnë. Qëlloi që një prej tyre të isha unë.

**OHI:** Si e gjetët temën të cilën do të trajtonit?

**Lirika Demiri:** Kjo pyetje më ka shtyer të kërkoj në grumbullin e fletoreve që i kam ruajtur nga shkolla e mesme. E në faqet e fundit të njërsës prej tyre, në mesin e disa shkarravinave matematikore, i gjeta të shënuara temat që në atë kohë më patën proekupuar dhe doja t'i fotografoja: Tika/qenushja e lagjes, treni/hekurudha, puna e fëmijëve, fshati Dubravë/jeta e komunitetit RAE, biblioteka... Kështu, gjetja e temës, ka qenë pjesë e një procesi të brendshëm kërkimor, një kurreshjtjeje artistike përmes së cilës fillova ta shikoj qytetin tim nga perspektiva e një fotografeje të re.

Tash që e mendoj, përcaktimi përfshatin e Dubravës dhe mënyrën e jetesës së komunitetit RAE ishte diçka intuitive, në kuptimin që nuk e dija saktësisht se çfarë do të mund të gjeja atje. Por e dija se çka nuk

doja të fotografoja, e ky ishte Ferizaj që e njihnin të gjithë: me muralin e kamarijerit, me kishën e xhaminë në të njëtin oborr e me bifurkacionin që shumicën e kohës qëndron pa ujë. Drejt Dubravës, më shtyu nevoja që të përballesha me varfërinë, mosarsimimin, me shtëpitë e improvizuara, me buzëqeshjet përkundër dhëmbëve të prishur e këmbëve të zbathura. Përmes fotografisë doja t'i përballja të gjithë me ngjyrat brenda marginave shqërore.

**OHI:** A ishte i vështirë akcesi në komunitetin RAE?

**Lirika Demiri:** Përkundrazi, komuniteti RAE të pret gjithmonë me shumë entuziazëm. Më të gëzuarit ishin fëmijët; në mesin e tyre kishte të atillë që nuk ishin fotografuar asnjëherë më parë. Ishte një ngjarje e madhe për ta, por edhe për mua. Unë ndjeja peshën e dokumentimit të lumturisë së tyre, përkundër gjendjes së rëndë në të cilën jetonin. Ndjeja se nuk do të mund të bëja mjaft për ta. E të moshuarit e lagjes, ata e dinin këtë, ishin mësuar me vizitorë kurresttarë që shkonin e vinin me xhepa plot pretime.

**OHI:** Çfarë të ka dhënë kjo eksperiencë?

**Lirika Demiri:** Kur ke në dorë një foto-aparat me të cilin nuk mund të shkrepësh më shumë se 30 fotografi, deshe s'deshe, të imponohet një lloj paralogaritje mbi momentet dhe subjektet. Prej kohësh nuk e kisha përdorur filmin fotografik, prandaj "Me Vendlindjen në Prapavi" ma riktheu ankthin që përfjetohet teksa përcjellë ndërrimin e numrit të fotove në kutizën e vogël, të bardhë. Në ato momente, bëhesh më e prerë e më kërkuese ndaj protagonistit dhe ndaj vvetveteve.

Është e çuditshme, në Dubravë, u pata gjendur e rrethuar nga një turmë fëmijësh që donin të fotografoheshin, i shfaqnën veçoritë e tyre më të mira para meje. E unë, si një koprrace, kërkova më ekspresiv/en, më fotogjenikun/en në mesin e tyre. Kur u publikua libri, pasqë se fotot e përzgjedhura ishin ato më spontanet, më të pa aranzhuarat. Mësova se shpesh duhet të fotografosh për hir të gëzimit të protagonistit tënd, edhe nëse kjo do të thotë që të heqësh dorë nga preferencat personale artistike.

**OHI:** A merresh sot me fotografi, nëse po, çka të intrigon të fotografosh?

**Lirika Demiri:** Unë nuk kam asnjë nga ata objektivët e mëdhenjë fotografik, e mund të kalojnë ditë e ditë pa bërë asnjë foto. Por fotografinë e shoh gjithkund; e shoh në dyert e autobusit që hapen e myllen mërzitshëm, në hapat e një të moshuari/e teksha mundohet të kalojë nëpër to, në monotoninë e një punëtori që rrotullon qebapa mbi zgarën e zbukuruar me perime të vyshkura - tamam si zbukurohen flokët e kuajve, në vendosshmërinë e një frizereje për ta drejtuar një kaqurrel të pabindur, në ballkonet pa

lule të ndërtimesave të kryeqytetit, në ironinë e dritareve përmes së cilave nuk depërton drita dot, e në entuziazmin e shitësve ambulantë.

E kam vërejtur se përmes fotografisë e kuptoj më mirë sociologjinë, arrij ta vizualizoj atë. Më intrigon ftohtësia e ndërtimeve fantom, të papërfunduara, dhe ajo e vendeve të braktisura; flet shumë për atë që do të mund të ishte, por njëkohësisht është simbolikë e heqjes dorë, e dorëzimit. Shpesh fotografoj thjesht për hir të kompozicionit të ngjyrave e formave, e edhe më shpesh nuk arrij ta "ngrij" fotografinë që shoh. Këto fotot e pashkrepura më ngajnjë me ëndrra të shuara, me iluzione të humbura. E janë pikërisht ato, që më shtyjnë ta dëgjoj përsëri atë "klik".